



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHITETASEN DHURATA SHAHINI  
BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR**

Spektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Dhurata Shahini** më datë **25.06.2024**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", neni 24, "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.44, datë 15.12.2023", për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj:

**JU RELATOJ:**

Familja e **Znj. Dhurata Shahini** me banim në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, e përbërë prej dy anëtarësh, kryefamiljari dhe bashkëshortja.  
Znj. Dhurata Shahini prej 9 vitesh ka probleme me shëndetin fizik, është trajtuar dhe kuruar me kimio-terapi dhe mjekime që kushtojnë. Sëmundja është rishfaqur përsëri dhe duhet të filloj me urgjent trajtimet mjeksore. Nuk merr asnjë lloj pagese pa aftësi për të përballuar shpenzimet.

E ndodhur në këto kushte të vështira për shëndetin e Znj. Dhurata Shahini, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasen Dhurata SHahini.

**Përgjegjëse e NE dhe PAK-së  
Teuta Hysenbelliu**

